

KONTRATË
SHITBLERJEJE KUOTASH

Sot më datë 21.01. 2019 (dymijë e nentembedhjete, palët e meposhtme, nenshkruajne kete Kontrate Shitblerje Kuotash, në përputhje me Kodin Civil, Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" dhe statutin e shoqërisë "KOALS" shpk, me kushtet e mëposhtme:

- **Z. Arian Zeneli** i datelindjes 23/08/1986, i biri i Brahimit, lindur ne Patos, Fier, dhe banues ne Patos, ne adresen : Lagjia „1Maji“ , Rr. „Koli Marku“ nr. 3/30, mbajtes i leternjoftimit me nr. Personal I60823067V, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar,(ne vijim "Shitesi")
- **Z. Eqerem Xhelili**, i datelindjes 03.05.1951, i biri i Ismail-it, lindur ne Tepelene dhe banues ne Tirane ne adresen: Rruga „Him Kolli“, Pll Llagami, kt. 8, mbajtes i leternjoftimit me nr. Personal F10503107A, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, (ne vijim "Bleresi")

Kushtet Paraprake

- a) Shitesi eshte pronar i nje kuote qe perfaqeson 100% te kapitalit themeltar te shoqerise "KOALS" shpk, shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, regjistruar prane Qendres Kombetare te Biznesit me date 14.12.2017, pajisur me numer unik identifikimi te subjektit (NUIS) me Nr. L72414012M, me seli ne adresen: Rruga „Albion Tershalla“, zona Unaza e Re, Kompleksi i pallateve „Santara“, Kati i Pare, Njesia nr. 23, Zk. 3866, Pasuria nr. 214/344-N23, Kashar, Yzberisht, Tirane, (ne vijim "Shoqeria");
- b) Shitesi ka si qellim ti shese bleresit kuoten e tij te percaktuar me siper ne shkronjen (a) te barabarte me 100% te kaptalit themeltar te Shoqerise, me vlere nominale 10,000 Leke (ne vijim "Kuota")
- c) Bleresi deshiron te bleje nga shitesi, Kuoten sipas kushteve dhe afateve te percaktuara ne vijim.

Palet, duke marre parasysh sa me siper, bien dakort si ne vijim:

Neni 1

Kushtet Paraprake

- 1.1 Kushtet paraprake te mesiperme jane pjese thelbesore dhe integruese e kesaj Kontrate.

Neni 2

Shitja e Kuotes

2.1 Nepermjet kesaj Kontrate, Shitesi I shet dhe I transferon Bleresit I cili, pranon dhe blen, Kuoten me nje cmim te barabarte me vlere te pergjithshme 10.000 leke (dhjete mije leke) (ne vijim referuar si Cmimi") ne perputhje me kushtet dhe afatet e parashikuara ne kete Kontrate.

Neni 3



Deklarime dhe Garanci te Shitesit

3.1 Shitesi deklaron dhe garanton se eshte I vetmi pronar dhe titullar I kuotes dhe te drejtave qe rrjedhin prej kesaj Kuote.

3.2 Shitesi deklaron dhe garanton se Kuota eshte teresisht e lire nga cdo peng , privilegj, barre siguruese, detyrim, garaci apo cdo e drejte tjeter ne favor te te treteve.

Neni 4

Korrespondenca

4.1 Te gjitha njoftimet, kerkesat dhe komunikimet e tjera ndermjet Paleve duhet te behen me shkrim dhe te dorezohen ne adresat perkatese te Bleresit dhe te Shitesit.

4.2 Te gjitha njoftimet, kerkesat dhe komunikimet e tjera do te dergohen me ane te letres rekomande me kthim pergjigje ose me poste elektronike.

Neni 5

Zgjidhja e mosmarveshjeve

5.1 Palet angazhohen te zgjidhin me mirekuptim cdo marveshje qe lidhet me interpretimin dhe ekzekutimin e kesaj Kontrate. Nese nje zgjidhje e tille nuk eshte e mundur, mosmarveshja do te zgjidhet eskuzivisht nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

Neni 6

E drejta e Zbatueshme

6.1 Kjo Kontrate dhe te drejtat e detyrimet e Paleve do te rregullohen ne baze te legjislacionit shqiptar ne fuqi.

Neni 7

Vlefshmeria- Kopjet Origjinale

7.1 Kjo Kontrate behet e vlefshme me nenshkrimin e saj nga Palet. Kjo Kontrate hartohet ne 3 (tre) kopje origjinale.

SHITESI

Arian Zeneli

Arian Zeneli
(Emer Mbiemer Firme)

BLERESI

Eqerem Xhelili

Eqerem Xhelili
(Emer Mbiemer Firme)